FSSHM
FONDI PËR SIGURIM SHËNDETSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

30 Dhjetor 2015

FSSHM
FONDI PËR SIGURIM SHËNDETSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

TETOVA SOT
shpejt dhe ndryshe

Aneks marrëveshje për zbutjen e dënimeve kontraktuale

Menjëherë pas përfundimit të negocijatave të suksesshme me Odën e mjekëve dhe Odën e stomatologëve, që rezultuan me përpilimin e aneks marrëveshjes së re për përfitimet e mjekëve amë dhe stomatologëve amë, Fondi në bashkpunim me Odën e farmacistëve të Maqedonisë shqyrtuan mundësitë për zbutjen e politikës së dënimeve që është në pajtueshmëri me propozimin e Qeverisë. Rezultat i kësaj ishte përpilimi i aneks marrëveshjes së re për barnatoret për vitin 2016. Qëllim i këtyre ndryshimeve është lehtësimi i punës së përditshme që bëjnë farmaceutët dhe barnatoret, si dhe zbutja dhe ulja e dënimeve kontraktuale.

Ndryshimet i dedikohen avansimit të punës elektronike për të ofruar shërbime më kualitative farmaceutike dhe përkujdes më të madh ndaj pacientëve. Aneks marrëveshjen Fondi do t'a fillojë në mënyrë elektronike me institucionet shëndetësore, duke shfrytëzuar nënshkrimin elektronik.

Në vijim, në mënyrë të detajuar do t'i përshkruajmë segmentet që u përkasin lehtësimeve të aneks marrëveshjes për vitin 2016:

- **Fshijmë 5 dënime kontraktuale:**

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

1. Nëse barnatorja nuk mban evidencë të rregullt ose nuk i mbron të dhënat elektronike;
2. Nëse vepron në kundërshtim me marrëveshjen për të cilën nuk është paraparë dënimi;
3. Nëse barnatorja deri në fund të ditës nuk i përpunon në kompjuter recetat për barnat e dhëna që mbulohen nga Fondi;
4. Nëse barnatorja nuk ka siguruar ose nuk shfrytëzon bar kod lexues;
5. Nëse barnatorja brenda afatit të përcaktuar kohor, nuk furnizohet ose nuk e ndryshon paisjen kompjuterike dhe të lidhet në internet.

- **Kemi bërë uljen e 8 dënimeve kontraktuale edhe atë, në vend të ½ e kompenzimit, me aneks marrëveshjen e re është paraparë Vërejtje (vetëm për shkeljen e parë, nëse e njejta përsëritet atëherë mbetet dënimi):**

1. Nëse barnatorja nuk i dorëzon tek Fondi të dhënat e kërkuara në pajtueshmëri me afatin e përcaktuar në marrëveshje;
2. Nëse nuk mban evidentim kontabël në pajtueshmëri me rregullat ligjore;
3. Nëse në librezën e shëndetësisë që i përket personit të siguruar, nuk e evidenton dhënien e barit;
4. Nëse lista e barnave pa kosto shtesë e zbritur nga web faqja zyrtare e Fondit, nuk është e printuar në format letre A3 dhe nëse nuk është e vendosur në vend të dukshëm për ta lexuar të siguruarit;
5. Nëse barnatorja nuk mban barna pa kosto shtesë, nga lista e barnave të përshkruar në formularin GLBD ose nuk ka dëshmi për arsyet pse bari nuk është i dorëzuar nga ana e prodhuesit ose shpërndarësit;
6. Nëse barnatorja nuk e Njofton me letër Fondin për çfarëdo lloj ndryshimi që bën (statusin, vendin,etj) në afat kohor prej 20 ditëve;
7. Nëse barnatorja nuk e Njofton me letër Fondin për ndryshimin e timit farmaceutik në afat kohor prej 20 ditëve;
8. Nëse barnatorja, përpos të gjitha barnave që i mban sipas nevojave të të siguruarve, nuk i siguron edhe barnat pa kosto shtesë.

- **E ulim masën e dy ndërpjerrjeve të marrëveshjeve të cilat kalojnë në gjoba financiare nga tre kompenzime mujore nëse:**

1. Barnatorja nuk i'a lejon Fondit ta kryejë kontrollën;
2. Barnatorja, pas marrëveshjes së nënshkruar, bën ndryshime në sigurimin e personelit (anëtarëve të timit) për kohë më të shkurtës se orari i plotë i punës.

- **Lehtësojmë dy dënime kontraktuale, nga kompenzimi mujor kalon në ½ e kompenzimit mujor nëse:**

1. Barnatorja nuk jep barna për të siguruarit e huaj;
2. Barnatorja i kryen pagesë të siguruarit për pjesëmarrje në kundërshtim me rregulloren e zbatueshme, nuk e evidenton në programin kompjuterik dhe nuk i jep llogari fiskale për pjesëmarrjen e paguar si dhe llogari fiskale për barnat me kosto shtesë.

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

- **Si mekanizëm efikas për mbrojtjen e personit të siguruar, Fondi do të fusë dy obligime të reja për barnatoret edhe atë:**

1. Në korzina të kuotës mujore, barnatoret obligohen të japin barna që janë në llogari të Fondit (nëse e posedon atë bar). Për këtë është paraparë gjobë financiare prej ½ e kompenzimit mujor;
2. Barnatorja obligohet të japë vërtetim për pjesëmarrjen e paguar (participimit) dhe llogari fiskale ku shihet qartë vlera e barnave që i mbulon Fondi, pjesëmarrja e personit të siguruar dhe vlera e barnave me kosto shtesë. Kjo risi duhet të fillojë të zbatohet nga 1 Prilli 2016 për të cilin është paraparë dënim kontraktual.

Ju rikujtojmë se, Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë nënshkruan marrëveshje me barnatoret për të dhënë barna me recetë. Deri në këtë moment, Fondi ka marrëveshje aktive me gjithsej 772 barnatore prej të cilave: 68 janë stacione farmaceutike, 6 janë barnatore mobile dhe 3 janë barnatore rurale. Buxheti që ka ndarë Fondi për barnat me recetë në vitin 2015 shënon vlerën prej 2 miliardë e 465 milion denarë. Nga të dhënat e Fondit, numri i recetave të realizuar për periudhën kohore 10 muajshe është gjithsej 17.424.010.

Dorëzimi i kartelave shëndetësore shtyhet për 20 në janar

Pak orë para Vitit të Ri ende nuk janë përpunuar 1/3 e kartave elektronike shëndetësore, edhe pse nga Fondinjoftuan se deri në fund të vitit, të gjithë qytetarët që jane ne pritje do ti marrin.

Alsat-M ka kërkuar informacione nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor deri ku është realizimi i projektit. Ngafondi u përgjigjën se dorëzimi i kartelave është shtyrë për 20 janar.

“Procesi për shtypjen e kartelave është në rrjedhje e sipër. Numri total i kartelave që duhet shtypur është 92.107 prej të cilëve 67.345 janë shtypur dhe shpërndarë në qendër të Fondit. Megjithatë, shpërndarja do të fillojë më 20 janar 2016, kur do të jenë të shtypura edhe pjesa tjetër e kartelave, përkatësisht 24.762”, thanë nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor.

Ndryshe në mes të këtij muaji drejtori i Fondit, Orhan Ramadani sqaroi se vonesa ishte për shkak të problemeve të caktuara, por se qytetarët së shpejti do ti marrin kartelat e tyre.

Disa qytetarë për kartelat e tyre presin gjithë vitin ndërsa për to kanë paguar nga 100 deri në 250 denarë në varësi të kategorisë.

FSSHM
FONDI PËR SIGURIM SHËNDETSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

RTM

Marrëveshje FSSH dhe Oda e Farmacistëve, zbuten dënimet për farmacistët

Nga 1 janari i vitit 2016, farmacistët dhe barnatoret nuk do të përballen me rregulla dhe dënime të ashpra, siç ishin deri më tani...

Kjo vjen si rezultat i një marrëveshjeje të re midis Fondit për Shëndetësi dhe Odës së Farmacistëve. Ndryshimet kanë për qëllim lehtësimin e punës së përditshme që bëjnë farmacistët dhe barnatoret, si dhe zbutjen e dënimeve kontraktuale, tha drejtori i FSSh-së, Orhan Ramadani.

"Aneks-marrëveshja e re parasheh fshirjen e pesë marrëveshjeve kontraktuale. Do të ulim tetë dënime kontraktuale, do të ulim masën e dy ndërprerjeve të marrëveshjeve të cilat kalojnë në gjoba financiare nga tre kompensime mujore. Lehtësojmë dy dënime kontraktuale, si mekanizëm efikas për mbrojtjen e personit të siguruar"- deklaroi drejtori i FSSH-së, Orhan Ramadani.

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

Në korniza të kuotës mujore barnatoret obligohen të japin barna që janë në llogari të Fondit nëse e posedon atë bar, por për këtë është paraparë gjobë financiare prej një të dytën e kapitacionit, sqaron Orhan Ramadani. Barnatorja gjithashtu obligohet t'i jep vërtetim për pjesëmarrjen e paguar të llogarisë fiskale, ku shihet qartë vlera e barnave që mbulon Fondi. Ndërkohë, nga Oda e Farmacistëve kanë mirëpritur ndryshimet e reja. Bistra Angellovska nga kjo Odë theksoi se këto ndryshime për farmacistët dhe veprimtaria e tyre nëpër barnatore do të thotë lehtësim i madh dhe lirim nga korniza e deritanishme ndëshkimore sipas ligjit.
Ndryshe, gjatë vitit 2015 për thyerje të ndryshme të ligjit janë ndëshkuar 89 barnatore. (Vlora Latifi-Topojani, TVM2)

ZHURNAL
Agjenci e Lajmeve

Kartelat shëndetosore dorëzohen deri më 20 Janar

Shkup, 30 dhjetor - Dy ditë para Vitit të Ri, ende nuk janë përpunuar një e treta e kartelave të planifikuara elektronike shëndetësore, edhe pse nga Fondi njoftuan se deri në fund të vitit, të gjithë qytetarët që i presin, do ti marrin. Alsat Maqedoni ka kërkuar informacione nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor deri ku është realizimi i projektit. Nga fondi u përgjigjën se dorëzimi i kartelave është shtyrë për 20 janar.

"Procesi për shtypjen e kartelave është në rrjedhje e sipër. Numri total i kartelave që duhet shtypur është 92.107 prej të cilëve 67.345 janë shtypur dhe shpërndarë në qendër të Fondit. Megjithatë, shpërndarja do të fillojë më 20 janar 2016, kur do të jenë të shtypura edhe pjesa tjetër e kartelave, përkatësisht 24.762", thanë nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor.

Ndryshe në mes të këtij muaji drejtori i Fondit, Orhan Ramadani sqaroi se vonesa ishte për shkak të problemeve të caktuara, por se qytetarët së shpejti do ti marrin kartelat e tyre.

Disa qytetarë për kartelat e tyre presin gjithë vitin ndërsa për to kanë paguar nga 100 deri në 250 denarë varësisht cilës kategori të qytetarëve i përkasin.

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

Thithja e këtij ajri është njejtë sikur të konsumojmë një pako cigare në ditë

Shkup, 30 dhjetor – Ekzistojnë të dhëna se tithja e 8 mikrogram në një m2 ajër është njejtë sikur të konsumojmë nga një pako cigare në ditë. Kështu bëjnë të ditur mjekët të cilët paralajmërojnë rezikun e kësaj gjendje, njofton Zhurnal.

Thuajse gjithë dhjetorin shkupjanët dhe tetovarët kanë thithur ajër të ndotur e nga 29 ditë të muajit vetëm 11 dhjetori ka qenë me ajër të pastër. Mjegulla dhe ajri i ndotur përvec se dëmton mushkëritë e bardha janë të dëmshme edhe për organet dhe funksionet tjera të trupit si sistemi kardiovaskular, sistemi nervor e vecanërisht nëse kemi shumë ditë me ajër të ndotur.

Ndahen pako me dhurata për fëmijët me nevoja të posaçme

Shkup, 29 dhjetor - Komuna e Gostivarit përmes Departamentit për Arsim, Kulturë dhe Sport dhe në bashkëpunim me kompaninë Ali Market, sot u shpërndanë dhurata nxënësve me nevoja të posaçme.

Me këtë aktivitet u përfshin paralelet speciale në shkollat fillore “Ismail Qemali” dhe “Mustafa Kemal Ataturk”, si dhe në Qendrën ditore për fëmijët me nevoja të posaçme.

“Tashmë disa vite, Komuna e Gostivarit vazhdon me aktivitetet tradicionale për shpërndarjen e pakove me dhurata për pjesën më të ndjeshme të popullatës, në këtë rast nxënësit me nevoja të posaçme. Nëpërmjet këtyre dhuratave modeste edhe Komuna e Gostivarit dëshiron të jetë pjesë e gëzimit të këtyre fëmijëve me rastin e festës së ndërrimit të motmoteve” theksoi Edit Azizi, përgjegjës për arsim në Komunën e Gostivarit, i cili shprehu mirënjohje për drejtuesit e Kompanisë "Extra Market Ali", që mundësuan këtë donacion.

Ai në emër të kryetarit të Komunës së Gostivarit, z.Nevzat Bejta fëmijëve ua uroi festën e Vitit të Ri me dëshirën që viti 2016 të jetë vit i mbarë dhe mbi të gjitha i suksesshëm për të gjithë nxënësit e shkollave të komunës së Gostivarit.

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

Agjencia për barna do të blejë terapi për të sëmurët nga kanceri

Shkup, 29 dhjetor- Parlamenti i miratoi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për barna dhe mjete mjekësore, me të cilat autorizohet Agjencia për barna, me propozim të ministrisë së shëndetësisë, në llogari të saj të blej barna për të sëmurët nga sëmundjet malinje, transmeton zhurnal.mk

Këto ndryshime ligjore u propozuan nga grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së.

Dr.Andon Cibishev, deputet nga VMRO-DPMNE, theksoi se bëhet fjalë për një projekt pilot i cili do të zgjas dymbëdhjetë muaj, në të cilin, Agjencia për barna nga mjetet e veta do t`i furnizoje barnat, për të qenë më të pranueshme për pacientët, shkruan vest.mk

“Bëhet fjalë për preparate të cilat janë linja e parë e tretmanit të sëmurëve të llojeve të caktuara të kancerit në lëkurë, kancerit të mushkërive dhe të pankreasit, të cilat nuk gjenden në listën pozitive të barnave, të cilat i mbulon Fondi i Sigurimit Shëndetësor”, deklaroi Cibishev.

Deputetët e LSDM-së u përmbajtën në votimin për ligjin, pasi që po e vlerësojnë si një marketing parazgjedhor dhe një masë populiste me të cilën do të i jepen kompetenca të zgjeruara Agjencisë së barnave.

“Do të autorizohet Agjencia e barnave për tu furnizuar me barna nga mjetet personale. Kjo hap dyshimet se Agjencisë do t`i jepen kompetenca të zgjeruara dhe funksion që nuk e ka asnjë e tillë në rajon dhe në Evropë”, theksoi Alen Geogriev, deputet nga LSDM-ja, transmeton zhurnal.mk

ALSAT M

Dorëzimi i kartelave shëndetsore deri më 20 janar

Dy ditë para Vitit të Ri nuk janë përpunuar një e treta e kartelave të planifikuara elektronike shëndetësore, edhe pse nga Fondi njoftuan se deri në fund të vitit, të gjithë qytetarët që i presin, do ti marrin. Alsat M ka kërkuar informacione nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor deri ku është realizimi i

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

TÜV AUSTRIA
CERTIFIED
EN ISO 9001
CERTIFICATE NO. 20 100 131352879
TÜV AUSTRIA CERT GMBH

projektit. Nga fondi u përgjigjën se dorëzimi i kartelave është shtyrë për 20 janar.

"Procesi për shtypjen e kartelave është në rrjedh e sipër. Numri total i kartelave që duhet shtypur është 92.107 prej të cilëve 67.345 janë shtypur dhe shpërndarë në qendër të Fondit. Megjithatë, shpërndarja do të fillojë më 20 janar 2016, kur do të jenë të shtypura edhe pjesa tjetër e kartelave, përkatësisht 24.762", thanë nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor.

Ndryshe në mes të këtij muaji drejtori i Fondit, Orhan Ramadani sqaroi se vonesa ishte për shkak të problemeve të caktuara, por se qytetarët së shpejti do ti marrin kartelat e tyre.

Disa qytetarë për kartelat e tyre presin gjithë vitin ndërsa për to kanë paguar nga 100 deri në 250 denarë varësisht cilës kategori të qytetarëve i përkasin.